

Gjyqtarja Anita Mici dërgohet për inspektim për lirimin e Lulzim Berishës

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit konfirmoi në detyrë gjyqtaren e Gjykatës së Apelit Durrës, Anita Mici dhe transferoi një çështje për inspektim.

Autor: [Edmond Hoxhaj](#) | BIRN | Tiranë



Gjyqtarja e Apelit të Durrësit, Anita Mici pas vendimit të konfirmimit nga KPK. Foto: Edmond Hoxhaj.

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit konfirmoi të martën në detyrë gjyqtaren e Apelit të Durrësit, Anita Mici, ndërsa vendosi të transferojë për inspektim vendimin e lirit nga burgu të Lulzim Berishës.

Vendimi u shpall nga trupa gjyqësore e drejtuar nga Lulzim Hamitaj, me relatore Brunilda Bekteshin dhe anëtar Olsi Komicin.

Anita Mici ka kryer studimet në Shkollën e Magjistraturës në vitet 2002-2005 dhe është emëruar fillimisht gjyqtare në Gjykatën e Shkodrës. Në vitin 2010, Mici u transferua në Gjykatën e Durrësit ndërsa në vitin 2016 u dekretua gjyqtare në Gjykatën e Apelit Durrës.

Gjatë seancës dëgjimore, Mici u përball me pyetje për vendimin si anëtare e trupës gjykuese të 5 dhjetorit 2016, që mundësoi lirimin e parakohshëm nga burgu për ish-kreun e bandës së Durrësit, Lulzim Berisha. Nga dënimi i tij prej 25 vitesh burg, Berisha vuajti fizikisht vetëm 10 vjet e 8 muaj dhe u lirua pas një serie vendimesh të diskutueshme të gjykatave dhe një garancie për punësim nga ish-kryebashkiaku i Durrësit, Vangjush Dako.

KPK vendosi transferimin e kësaj çështjeje në ILD, pavarësisht një opinioni kritik të ONM-së lidhur me praktikën e përsëritur të referimeve nga shkalla e parë e vetingut. KPK rrëzoi gjithashtu një raport papërshtatshmërie të DSIK për gjyqtaren Mici.



RRETH AUTORIT

Edmond Hoxhaj

Edmond Hoxhaj është gazetar i Rrjetit Ballkanik për Gazetari Investigative në Shqipëri. Ai ka punuar më herët për gazetën “Shqip”. Ai ka përfunduar studimet në Universitetin e Tiranës në degën Gjuhë-Letërsi. Hoxhaj ka punuar që nga viti 2001 në disa media të shkruara, ku ka mbuluar çështjet e aktualitetit dhe të drejtësisë.